



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prodato Received / Delivery	18-05-2021	1	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKESHOK	2448/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.366/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti-kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtar, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2775/2019 të datës 23.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën A.nr 619/2019 të datës 11.10.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Lagjen "Dardania" SU2/10 nr. 13 Prishtinë, kundër organit të punësimit-Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar me ankesën Nr. 619/2019, e datës 11.10.2019 e parashtruar nga ankuesi dhe sipas Aktgjykimit A.nr.2775/2019 të datës 23.04.2021.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit Nr.02/244/09 të datës 10.08.2015 në pozitën "Udhëheqës i Ekipit" në Divizionin e Tatimpaguesve të Mëdhenj në Administratën Tatimore të Kosovës me koeficient të pagës 8.5 (tetë pikë pesë), me Vendimin Nr.11/510/A të datës 07.08.2019 të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, është transferuar në pozitën "Zyrtar i lartë për ligjin e Administratës Tatimore dhe Procedurat në Departamentin e Kontrollit".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.11/510/A të datës 07.08.2019, më datën 30.08.2019 ka parashtruar ankesën me Nr.11-06-3465 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, më datën 18.09.2019, me numër te protokollit 11-190 nxjerr Vendimin, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si te bazuar ankesën e datës 30.08.2019, të parashtruar nga ankuesi

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin 11-190 të datës 18.09.2019, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, brenda afatit ligjor konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 11.10.2019 parashtron ankesën me numër protokollit 4751/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.10.2019 tek Administrata Tatimore e Kosovës ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit. Me datë 25.10.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020,ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 05.11.2019,Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi _____ i pakënaqur me njoftimin e datës 05.11.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.2775/19 të datës 23.04.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, dhe duke detyruar Këshillin që të vendos në lidhje me ankesën e datës 11.10.2019 të ankuesit

Kolegji bazuar ne aktgjykimin e lartpërmendur për shqyrtimin e ankesës për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër te protokollit 4751/2019 të datës 11.10.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Vendimi Nr.11/510/A i datës 07.08.2019 për transferim të kandidatit _____ Vendimi i datës 18.09.2019 me numër te protokollit 11-190 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave:Vendimi i datës 23.09.2019 me numër te protokollit 730 për ndryshim dhe plotësim të vendimit Nr.11/510A të lëshuar me datë 23.09.2019: Akt Emërimi i datës 10.08.2015 me numër te protokollit 02/244/09 i ankuesi

Provat e mësipërme janë dorëzuar nga ankuesi dhe janë të evidentuara në këtë vendim sipas renditjes me numra.

Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 17.10.2019 me numër te protokollit 4894/2019 dërguar organit te punësimit nga KPMSHCK-ja.



Ndërsa me poshtë e janë provat që janë objekt të administrimit dorëzuar nga organi i punësimit:

Përgjigja në kërkesë e datës 24.10.2019 me numër të protokollit 5036/2019; Shkresë e datës 10.05.2019 lidhur në strukturën e përgjithshme organizative të Administratës Tatimore; Rregullorja Nr. ATK 13/2019 e datës 17.05.2019 me numër të protokollit 09.06.2149 për Organizimin e brendshëm sistematizimin e vendeve të punës në administratën tatimore të Kosovës përberë nga 34-faqe; Emaili i datës 25.10.2019; Emaili i datës 01.08.2019; **Ndërsa nga organi i punësimit janë dorëzuar edhe vendimet e datës 07.08.2019, 23.09.2019 18.09.2019:** Ankese e datës 30.08.2019 me numër të protokollit 11-06-3465 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Emaili i datës 01.08.2019 por të cilat prova nuk u specifikuan më shumë pasi janë specifikuar më lartë nga se janë dorëzuar nga dy palët.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë është bërë i pamundur apo i kotë andaj edhe mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse,**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 97 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku shprehimisht thuhet se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ ..."*, që në rastin konkret procedura administrative e nisur kundër Vendimit Nr. 11-190 të datës 18.09.2019 ka përfunduar mbi bazë të njoftimit/emailit të datës 21/12/2020, të konfirmuar përmes shkresës/emailit zyrtarë të datës 12/05/2021 nga Burimet Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës përmes së cilit fakt kolegji ka konstatuar se transferimi i nëpunësit civil tashmë ka përfunduar pasi nëpunësi civil/ankuesi është kthyer në pozitën e mëparshme sipas Akt Emërimit të datës 10.08.2015 me numër të protokollit 02/244/09 "Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të mëdhenj".

Poashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 104 ku është përcaktuar se : *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e inicuar nga ankuesi përmes ankesës me numër A.nr.619/2019 të parashtruar me datë 11.10.2019 është bërë i pamundur apo i kotë, respektivisht vendimi i goditur me ankesë është shfuqizuar dhe si i tillë nuk prodhon pasoja juridike në raport me ankuesin andaj edhe kanë pushuar arsyet ligjore që të vendoset ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.366/2021, datë 18/05/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

